



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 29 maj 2013, në orën 13:30, sala N-303
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Ramiz Lladrovci, Adem Grabovci, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Bali Muharremaj dhe Imri Ahmeti.

Të ftuar: Z. Sami Kurteshi, Avokat i Populli dhe Lars Lage Olofsson - auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22.05.2013;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;**
4. **Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22.05.2013

Kryetari- Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi, njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 22.05.2013

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012

Kryetari – Sipas vlerësimit të ZAP-it, ky institucion ka opinionin e pakualifikuar, që nënkupton se pasqyrat financiare janë prezantuar drejt dhe nuk ka shkelje materiale, me përjashtim të pasqyrave vjetore financiare 9 mujore të vitit të kaluar që nuk ishin hartuar. Pyeti: lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dala nga viti i kaluar. Vitin e kaluar ZAP ka dhënë 9 rekomandime për IAP dhe lidhur me këtë kjo e fundit ka përgatitur një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit. Prej tyre të adresuara plotësisht ishin 3, pjesërisht të adresuara ishin 4, ndërsa 2 prej tyre nuk ishin adresuar fare(regjistrimet në kode ekonomike të gabuara, shpenzimet e larta të telefonisë fikse).

Buxheti i vitit 2012 - IAP ka laramani të financimit si nga Grandi Qeveritar, po ashtu një pjesë nga donacionet. Marr në përgjithësi nga ndarja prej 704,649 euro për vitin 2012 IAP ka shpenzuar 638,270 euro, ose 91 % e buxhetit në total. Shpenzimi më i lartë ishte realizuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve prej 96.3% e totali të ndarjes buxhetore në këtë kategori.

Valbona Dibra –Opinionin për IAP është i pakualifikuar, që është opinionin më i mirë i mundshëm. Do të thotë që pasqyrat financiare që janë prezantuar paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Përgëzoj institucionin dhe menaxhmentin e Avokatit të Popullit për përmirësimet që i ka bërë, krahasuar me vitet e kaluara, por janë disa të gjetura të cilat edhe pse nuk kanë ndikim material, megjithatë mbeten shqetësuese për Komisionin. Në fushën e prokurimit nga 90 kontrata të lidhura në vitin 2012, 88 prej tyre janë me kuotim të çmimeve. Pse një numër kaq i madh i kontratave kanë shkuar në kuotim të çmimeve? Pastaj, me çfarë baze juridike e kanë marrë një vendim për shpenzimet e reprezentacionit për zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit, duke i përfshirë këtu të gjithë zyrtarët? Reprezentacioni lejohet vetëm për Avokatin e Popullit, zëvendësavokatin e Popullit, por jo për drejtorin ekzekutiv, drejtorët e departamenteve dhe zyrtarët e tjerë.

Albert Kinolli – Pyeti, lidhur me vonesat në implementim të projekteve që financohen nga donacionet e jashtme, ku në vitin 2012 IAP pranuar 3 donacione të jashtme me vlerë prej 23,339 euro, donacioni turk prej 2,374 euro, donacioni norvegjez 7,205 euro , dhe donacioni për projektin „Save the Children” me vlerë 13,760 euro i cili është dashtë të realizohet në marrëveshjen e parë më 1 shkurt 2012 deri më 31 maj 2012, e cila marrëveshje është zgjatur edhe dy herë edhe nuk është arritur që të finalizohet.

Afrim Hoti- Pyeti, IAP nuk kishte arritur të përgatisë pasqyrat vjetore financiare 9 mujore, ashtu siç kërkohet me rregullat financiare 06/2011. Çfarë masa ka ndërmarrë menaxhmenti ndaj zyrtarit kryesor financiar me rastin e mos përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare nëntëmujore (PVF)?

Ramiz Lladrovci – Shtroi çështjen e regjistrimit të shpenzimeve në kode ekonomike të gabuara, kjo është në kundërshtim me rregullat e thesarit. IAP ka pasur një tender për blerjen e një aparati fotokopjues, por ka dështuar për shkak se operatorët nuk kanë mundur të ofrojnë modelin të cilin e ka kërkuar IAP. Me ligj nuk keni të drejtë të kërkonin në tender për modelin, por duhet të parashtrohen specifikat e tenderit. Sa i përket raportit do ta përkrah, është me opinion të pakualifikuar, që është opinionin ma i mirë i mundshëm.

Sami Kurteshi –Avokat i Popullit – Lidhur me vendimin për shpenzimet e reprezentacionit për një pjesë të administratës, dhe kjo nuk është shkelje, për zëvendësavokat dhe për dy

drejtorë të tjerë, ku janë 8 persona gjithsej. Sa i përket serverit këta kanë qenë serverë të vjetër ku kemi pas një server të vjetër që është djeg krejt dhe kemi humbur të dhënat, mirëpo me vonë është arritur që të nxirren shënimet. Unë kam urdhëruar me qenë tre serverë për garantim. Sa i përket pagave të ndryshme nga akt-emërimet, në IAP është drejtor i hetimeve ushtrues detyre. Që ai është ushtrues detyre ky ka qenë vendimi im, kjo për shkak të përvojës së kaluar. Këtë vendim kam marrë për të mos ardhur në situatën në të cilën ishim kur drejtori i mëhershëm ka lënë punën. Atëherë ne jemi në një situatë që nuk kemi kuadro për përgatitje. Prandaj, unë dua ta bëjë me rrotacion 1 vit një bashkëpunëtor, që të mos bëhen vendimet e përhershme.

Jashar Kastrati, drejtor ekzekutiv IAP- Zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar është duke shkuar mirë, në përjashtim të dy rekomandimeve që i ka dhënë ZAP në raportin e vitit 2012.

Kryetari – Gjendja është e konstatuar nga ZAP, mirëpo shtrohet pyetja se Ju çka keni ndërmarrë në përmirësim të situatës, të thuhet se kanë humbur shënimet e një viti në server nuk është justifikim. Po ashtu nuk ka pasur mjete të planifikuara për servisim të veturës dhe ju e keni bërë këtë.

Sami Kurteshi –Avokat i Popullit – Sa i përket serverit ajo është një çështje që lidhet drejtpërdrejt me misionin e punës tonë. Unë kam urdhëruar që të jenë serverë të ndryshëm dhe ajo teknikisht është rregulluar. Kanë blerë serverë, të dhënat janë kthyer, janë riparuar të gjithat kjo domethënë ka qenë një punë shtesë.

Murselj Haljilji – Përshëndet avancimet e bëra nga viti i kaluar, po ashtu dobësitë e theksuara në këtë raport janë nga mos zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar, si në rastin e regjistrimit të shpenzimeve në kode ekonomike të gabuara, po ashtu çështja e pagesës për shpenzime të reprezenacionit nga paraja e gatshme, kur një gjë e tillë nuk lejohet. Po ashtu pozita e zëvendës drejtorit të Drejtorisë së Hetimeve që mbahet si pozicion vetëm si ushtrues detyre.

Sami Kurteshi –Avokat i Popullit – Serverët janë serverë të veçantë që ruhen vetëm në institucione për shkak të mundësisë të intervenimit ku ne tani kemi bërë sigurim të dyfishtë. Të dhënat janë kthyer. Sa i përket masave zyrtarit për prokurim është shkarkuar. Momentalisht kemi pasur një zyrtar, po prapë është tërhequr dhe tani është një zyrtar i përkohshëm. Aktualisht konkursi është i hapur për një zyrtar të ri.

Sa i përket drejtorit të hetimeve e sqarova një herë në fund të vitit 2010 ka dhanë dorëheqje drejtori i hetimeve me një afat që nuk i përket punës së institucioneve ku ka punë për 6 vjet edhe jep dorëheqje me një afat shumë të shkurtër. Në atë moment jemi gjendur në një situatë jo të lakmueshme. Ai njeri që kemi menduar që është shumë i besueshëm dhe që mundet të kryejë punën është zgjedhur si gjykatës. Është dashtë të emërohet një person tjetër që ne kemi menduar që është më i përshtatshëm. Ky person e ka kryer punën për një vit. IAP ka krijuar një zyrë të hetimeve prej tre vetëve - një udhëheqës i zyrës edhe dy zëvendës. Unë jam i interesuar që zyra e hetimeve që është degë e institucionit, të ketë 6 punëtorë - një udhëheqës dy zëvendës dhe tre asistentë ligjorë që ta udhëheqin krejt punën institucionale të institucionit që është e pa ndikuar nga jashtë nga politika dhe nga Avokati i Popullit. Qëllimi është që ajo zyre të profesionalizohet dhe të mos marrë urdhër nga jashtë operative dhe të jenë të gatshëm në çfarëdo rasti.

Ramiz Lladrovci – Humbja e të dhënave është shumë shqetësuese, por meqenëse deklaruar se i keni kthyer ato të dhëna, atëherë çdo gjë është në rregull. Për organizim të stafit është mirë që IAP të bëjë plane dhe t'i propozojë Komisionit për Buxhet dhe Financa, por duhet të respektohet ligji dhe IAP të mos ketë të gjeturat e ZAP-it.

Lars Lage Olofsson – Së pari jam i kënaqur me faktin që ka përmirësim, sa i përket mënyrës

mendoj që është pak e ngadalshme. Sa i përket shërbimit të telefonave mobil, situatës së prokurimit, ajo se çka mund ta shohë janë vendime që i përkasin punës dhe për shfrytëzimin e parasë publike. Mendoj se në këto fusha ka kohë ende për përmirësim dhe ky përmirësim do të ndodhë. Një gjë është e sigurt se në këtë do ta përcjellim në vjeshtë dhe mendoj që Avokati i Popullit e kupton këto çështje që u ngritën këtu, si dhe rekomandimet tona.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 1. Raporti i Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012, nuk procedohet në mbledhje plenare.*
- 2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, me auditimin e ndërmjetëm për Institucioni e Avokatit të Popullit, të përcjellë zbatimin e rekomandimeve, dhe lidhur me këtë ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu